

BIBLIOTEKA KOMBËTARE NUK DËSHIRON T'I LIDHË BIBLIOTEKAT NË KOSOVË NË SISTEMIN KOMBËTAR BIBLIOTEKAR

Në interes të kujt është izolimi i bibliotekave në Kosovë?

Nuk ka menaxhim të integruar të katalogëve dhe bibliografive

SHKRUAN:
TOMA SELJAK

Probleme me programin Aleph-500 ka edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në Zagreb.

Në 25 vitet e fundit vetëm 15 punonjës të bibliotekave në Kosovë kanë marrë kualifikimin formal në studimet pasuniversitare me korrespondencë në fushën e bibliotekarisë në Universitetin e Zarës (2007/2008) ose në Universitetin e Lubjanës (2009/2010)

Ka më shumë se 25 vjet që ndjek zhvillimin e bibliotekave në Kosovë dhe gjatë kësaj kohe kam koordinuar programe të ndryshme për ndihmë në zhvillimin e bibliotekave, duke filluar me implementimin e aplikacioneve të para kompjuterike për katalogimin e përbashkët në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK) në vitin 1989. Sot mund të konstatojmë se bibliotekat në Kosovë, pavarësisht numrit të madh të nxitjeve për zhvillim, ende veprojnë të izoluar dhe nuk janë të lidhura në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar dhe në rrjetin rajonal COBISS.Net (www.cobiss.net), i cili lidh më shumë se 780 biblioteka nga 7 shtete, mes tyre 29 nga Shqipëria. Si është kjo e mundur?

NË BOTË NJIHEN DY QASJE PËR AUTOMATIZIMIN E BIBLIOTEKËS:

- Bibliotekat lidhen në sistemet dhe rrjetet bibliotekare të informacionit përmes rregullave unike për përpunimin e përbashkët të materialeve bibliotekare dhe shkëmbimin e regjistrimeve bibliografike, ndërsa duke paguar anëtarësinë ato marrin në përdorim programin, i cili ndryshe nuk mund të blihet (shembull: COBISS.Net, OCLC).
- Bibliotekat blejnë programe më pak ose më shumë të përshtatshme (në tregun botëror ekzistojnë shumë ofertues), vetëpërcaktojnë rregullat për përpunimin e materialeve bibliotekare, katalogimi i përbashkët zakonisht nuk implementohet, ndërsa kontrolli mbi kualitetin e regjistrimeve bibliografike nuk është i detyrueshëm (shembuj: Aleph, Koha, Adlib).

PROGRAMI I SHITRENJTË DHE JOFUNKSIONAL

Në vitin 2003 Ministria e Kulturës e Kosovës dhe IZUM-i nga Maribori përgatitën një projekt për lidhjen kompjuterike të bibliotekave në një sistem unik "Biblioteka virtuale e Kosovës" në platformën COBISS, por bashkëpunimi me BKUK-në ishte i pamundur të realizohej.

BKUK në vitin 2004 zgjodhi qasjen tjetër dhe bleu një program shumë të shtrenjtë Aleph 500 për aplikacionet lokale bibliotekare (pasurimi, katalogimi, huazimi ...), por pa organizim paraprak të definuar të sistemit kombëtar bibliotekar të informacionit, pa katalogun e përbashkët, pa aftësim të organizuar të bibliotekarëve (bibliografëve/kataloguesve), pa mbikëqyrje të kualitetit të bazës së të dhënave dhe pa manuale për përdoruesit në gjuhën shqipe. Në vitin 2006 BKUK ka pranuar ftesën për t'u bashkuar rrjetit COBISS.Net, të cilën e kanë nënshkruar në Shkup drejtorët e pesë bibliotekave kombëtare nga rajoni dhe drejtori i IZUM-it. Përgjigje nuk ka pasur! Pavarësisht kësaj, Qeveria e Republikës së Sllovenisë në kuadër të projektit COBISS.Net në periudhën 2006-2010 ka financuar programe të ndryshme për zhvillim për të ndihmuar bibliotekat në Kosovë në vlerë prej 365.000 EURO:

- 30 bibliotekave u janë dhuruar pajisjet e domosdoshme kompjuterike (2-5 PC dhe një printer).
- 18 të pënuësuarve në biblioteka u janë financuar studimet pasdiplomike në shkencën e bibliotekës (16 në Universitetin e Zarës dhe 2 në Universitetin e Lubjanës), prej të cilëve deri tani kanë diplomuar 15,
- është organizuar trajnimi një javor për kompjuter për 112 bibliotekarë në Prishtinë dhe trajnim dy javor në Slloveni për 20 bibliotekar nga Kosova,
- është mundësuar përkthimi i standardeve ndërkombëtare bibliografike (ISBD) si dhe manualeve e ndërfaqeve COBISS në gjuhën shqipe,
- konferencat ndërkombëtare COBISS dhe EUROCRIS i kanë ndjekur mbi 50 përfaqësues të bibliotekave dhe institucioneve të tjera nga Kosova. Të gjitha këto aktivitete i ka koordinuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila atëherë nuk ka qenë përgjegjëse

Shpeshohet se ministritë përgjegjëse të Republikës së Kosovës të përkrahin propozimin e IZUM-it drejtuar Komisionit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që projekti COBISS.Net në periudhën 2016 - 2018 të financohet nga fondet e Bashkimit Evropian - programi IPA. Projekti, pos të tjerave, përfshin edhe studimet pasdiplomike me korrespondencë në fushën e bibliotekarisë në Universitetin e Shkodrës me qëllim forcimin e kuadrit të bibliotekave në Shqipëri dhe në Kosovë.

për BKUK-në dhe nuk ka mundur të ndikojë në politikën e drejtorit të BKUK-së, i cili në mënyrë kategorike ka kundërshtuar përfshirjen e Kosovës në rrjetin rajonal COBISS.Net. Ndërsa, Ministria për Arsimit, Shkencë dhe Teknologji si duket nuk e ka ditur se nuk ka dashur ta di, se sa shkatërruese është kjo politikë e izolimit të bibliotekave në Kosovë.

BASHKËPUNIMI KOSOVË-SLLOVENI NË FUSHËN E BIBLIOTEKARISË

Në tetor të vitit 2010 është nënshkruar edhe një Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Sllovenisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në kulturë, arsim dhe shkencë, në të cilën paragrafi i tretë i nenit 2 thotë: "Palët nënshkruese pajtohen, që edhe më tutje do të krijojnë kushte për bashkëpunim në kuadër të projektit COBISS.Net". Por edhe pas kësaj nuk ka ndryshuar asgjë dhe për këtë arsye bibliotekat në Kosovë kanë mbetur pa ndihmën për zhvillim. Në qarqet e bibliotekareve profesionale dhe në mediat kosovare tashmë një kohë të gjatë flitet dhe shkruhet, se si Biblioteka Kombëtare e Kosovës (BKK) paguan mirëmbajtjen e programit Aleph-500, funksionet e të cilit nuk i shfrytëzojnë mjaftueshëm. Është vështirë të kuptohen ata, të cilët njëmbëdhjetë vjet pas blerjes së programit Aleph-500 ende shpëjgojnë, se të punësuarit në bibliotekat kombëtare nuk janë mjaftueshëm të kualifikuar për përdorimin e këtij programi, se bibliotekës i mungon stafi profesional në fushën e teknologjisë së informacionit dhe në gjuhën angleze, etj. Ndërkohë, menaxhimi i Bibliotekës Kombëtare thotë se nuk ka pasur zgjidhje tjetër përveçse të paguajnë mirëmbajtjen e programit Aleph-500 edhe për një vit, ndërsa grupi i veçantë i ekspertëve do të vlerësojë nëse ia vlen të vazhdohet me pagesat për mirëmbajtjen e tij.

Ne vetëm mund të shpeshojmë që grupi i lartpërmendur i ekspertëve fillimisht të konstatojë se çfarë funksione duhet të ketë programi për automatizimin e shërbimeve bibliotekare, në mënyrë që të plotësojë nevojat e bibliotekave në Kosovë. Biblioteka Kombëtare me siguri nuk dëshiron t'i lidhë bibliotekat në Kosovë në sistemin kombëtar bibliotekar të informacionit me katalogimin e përbashkët dhe katalogun e përbashkët (qendror) bibliotekar si dhe me menaxhimin e integruar të katalogëve dhe bibliografive, sepse programi Aleph-500 këtë nuk e mundëson. Ofertuesi i programit Aleph-500 (Ex Libris) gjithashtu nuk siguron as ndërfaqet (interface) për përdoruesit, as manualet dhe as kualifikimin në gjuhën shqipe.

MIRËMBAJTJA E SHITRENJTË

Nëse bibliotekat në Kosovë dëshirojnë të lidhen në sistemin kombëtar bibliotekar të informacionit me katalogimin e përbashkët, ekziston vetëm një mundësi (optimale) - implementimi i sistemit COBISS dhe përfshirja në rrjetin rajonal COBISS.Net, të cilin e zhvillon dhe e mirëmban IZUM-i Qendra Rajonale e UNESCO-s për zhvillimin e

sistemeve bibliotekare të informacionit dhe sistemeve të informacionit për veprimtari shkencore. Bibliotekave në këtë rrjet u mundësohet qasja në më shumë se 10 milionë regjistrime bibliografike, të cilat gjatë procesit të katalogimit të përbashkët mund t'i shkarkojnë pa pagesë në bazën e tyre të të dhënave dhe në këtë mënyrë i shmangen shpenzimeve të mëdha për krijimin e regjistrimeve origjinale bibliografike. Për krahasim: njëmbëdhjetë vjet pas fillimit të përdorimit të programit Aleph-500 BKK në bazën e vet të të dhënave ka diçka më shumë se 75.000 regjistrime bibliografike, ndërsa bibliotekat në Shqipëri tre vjet pas themelimit të sistemit COBISS.AL në bazën e përbashkët të të dhënave COBIB.AL kanë më shumë se 91.000 regjistrime. Natyrisht, që BKK nuk ka pasur mundësi tjetër përveçse të paguajnë mirëmbajtjen e programit Aleph-500 edhe për një vit, por kjo pagesë nuk është bërë për periudhën në vazhdim, mirëpo për periudhën nga shkurti 2015 deri në shkurt 2016. Gjithashtu, është e vërtetë se IZUM në fund të shtatorit të vitit 2015 i ka ofruar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit implementimin e sistemit COBISS në Kosovë në kuadër të programit ndërkombëtar për ndihmë në zhvillim. BKK për këtë do të duhej të paguante vetëm 1.000 EURO. Fazën e parë të kualifikimit të kataloguesve të BKK-së (në gjuhën shqipe dhe me ndihmën e bashkëpunëtorëve nga Shqipëria) dhe transferimin e bazës së të dhënave të BKK-së në COBISS.KS, IZUM-i ka qenë i gatshëm ta realizojë deri në fund të vitit 2015. Ndërkohë edhe shpenzimet vjetore për mirëmbajtjen e sistemit COBISS.KS do të ishin më të ulëta se sa për mirëmbajtjen e programit Aleph-500. Drejtuesit aktual të BKK-së (ende) nuk i janë përgjigjur kësaj oferte.

Në lidhje me këtë duhet të dimë, që Aleph-500 dhe COBISS janë dy gjera tërësisht të ndryshme. Aleph-500 është program (software) komercial për automatizimin e shërbimeve bibliotekare, ndërsa COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online) është platformë jofitimprurëse e sistemeve kombëtare bibliotekare të informacionit në rrjetin COBISS.Net. Pjesë përbërëse e kësaj platforme është edhe programi, i cili nuk mund të blihet, por atë bibliotekat e marrin në përdorim, nëse lidhen në sistemin kombëtar bibliotekar dhe pranojnë rregullat e shkëmbimit pa pagesë të regjistrimeve bibliografike në rrjetin COBISS.Net. Gjë e cila bibliotekave në procesin e katalogimit të përbashkët u sjellë kursime të jashtëzakonshme financiare dhe kohore. Pra, bëhet fjalë për dy koncepte shumë të ndryshme të informatizimit të bibliotekave.

MUNGESA E STUDIMEVE TË BIBLIOTEKARISË

Për implementimin e sistemit COBISS në Kosovë nuk është e detyrueshme që bibliotekarët të njohin gjuhën angleze. Të gjitha ndërfaqet e përdoruesit dhe manualet janë në gjuhën shqipe, si dhe kualifikimi për katalogimin e përbashkët zhvillohet në gjuhën shqipe. Ndërsa problem serioz përbën fakti, se shumica e bibliotekarëve në Kosovë nuk janë të

kualifikuar në fushën e bibliotekarisë, gjë e cila sot në botën e zhvilluar është kusht për shumicën e vendeve të punës në bibliotekë. Në fakt në Kosovë nuk ka studime universitare në fushën e bibliotekarisë, ndërsa Biblioteka Kombëtare nuk organizon as trajnimet për provimin profesional në këtë fushë. Në 25 vitet e fundit vetëm 15 punonjës të bibliotekave në Kosovë kanë marrë kualifikimin formal në studimet pasuniversitare me korrespondencë në fushën e bibliotekarisë në Universitetin e Zarës (2007/2008) ose në Universitetin e Lubjanës (2009/2010). Këto studime janë organizuar në kuadër të projektit COBISS.Net dhe i ka financuar Qeveria e Republikës së Sllovenisë, me qëllim ofrimin e ndihmës për zhvillim për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Për krahasim: në Slloveni, e cila për nga numri i banorëve është e ngjashme me Kosovën, në biblioteka janë të punësuar më shumë se 600 bibliotekar me, së paku, kualifikim universitar në fushën e bibliotekarisë.

Edhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, e cila përdor programin Adlib, ende nuk i është përgjigjur ofertës së IZUM-it për përfshirje në sistemin COBISS.AL. Tashmë dihet, se drejtori i mëparshëm i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitetit të Kosovës, dr. Sali Bashota, dhe drejtori i mëparshëm i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, dr. Aurel Plasari, nga arsye të pakuptueshme së bashku kanë kundërshtuar përfshirjen në COBISS.Net duke mbështetur njëri-tjetrin. Mes të tjerave ata kanë shpikur edhe "armikun e përbashkët" - gjoja sistemi COBISS na qenka "slav", çfarë është vështirë të kuptohet, sepse Kosova për shumë gjera merr model Sllovenisë. Disa në Kosovë ende mendojnë, se "ekziston frika, se serbët do të vëdhin regjistrimet nga baza e BKK-së". Çfarë absurditeti! Nga baza e përbashkët e të dhënave të Serbisë (COBIB.SR) në bazën e përbashkët të të dhënave të Shqipërisë (COBIB.AL) deri tani janë shkarkuar 5.838 regjistrime bibliografike, ndërsa anasjelltas 21 regjistrime. Është shumë e qartë se kush ka më shumë doli nga bashkëpunimi. Përveç kësaj, edhe Kosova aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian dhe për të arritur këtë, një nga kushtet që duhet plotësuar është bashkëpunimi me fqinjët. Për shoqërinë e informacionit, e cila mbështet fuqishëm zhvillimin e bazuar në dije, sistemet bibliotekare të informacionit dhe ato të veprimtari kërkimore shkencore janë pjesë shumë të rëndësishme të infrastrukturës, pa të cilat nuk mund të mendohet zhvillimi i arsimit bashkëkohor, i kërkimeve shkencore, dhe as zhvillimi kulturor, teknologjik dhe ekonomik. Bibliotekat nuk mund të funksionojnë suksesshëm të izoluar nga njëra-tjetra, prandaj duhet të lidhen bashkë dhe të sigurojnë kushtet për dia-log dhe bashkëpunim. Kjo siguron bazën më të mirë për zhvillimin e çdo vendi në veçanti, dhe të bashkësisë ndërkombëtare në tërësi. Në interes të kujt është zarrizja e zhvillimit dhe izolimi i bibliotekave në Kosovë? Në interes të atyre, të cilët bëjnë përpjekje për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, me siguri jo!

(Autori është koordinator i projektit COBISS.Net, IZUM, Maribor, Slloveni)